



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJAKOVËS
OSNOVNI SUD GJAKOVA – BASIC COURT OF GJAKOVA



Në baze të nenit 3 të Rregullores nr.08/2017 , për praktikantë vullnetarë, Gjykata Themelore Gjakovë, më datë 04.03.2024, shpall:

K O N K U R S
Nr. 01/2024

Titulli i vendit të punës: Praktikant/ë vullnetar/e 40 (dyzet) pozita.

Nëpunësi mbikëqyrës: Administratori i Gjykatës, për degët-Ndihmës Administratori

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të caktuar, në kohëzgjatje prej një viti (pa pagesë).

Vendi: Gjykata Themelore Gjakovë----- 20 pozita
Dega Rahovec -----10 pozita
Dega Malishevë -----10 pozita

Përshkrimi i detyrave të punës:

Detyra e praktikantit: Ndihton zyrën e administratës në organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe menaxhimin e tyre në përgjithësi.

Detyrat kryesore: Vepron në mbikëqyrjen e drejtpërsëdrejti të kryetarit të Gjykatës-Gjyqtari Mbikëqyrës dhe nën mbikëqyrjen e përgjithshme të administratorit-Ndihmës-Administratorit të Degës; Ndihton punën në zyrën e administratës lidhur me organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe në menaxhimin e tyre në përgjithësi ;
Ndihton gjyqtarët në punë që kanë të bëjnë me futjen e lëndëve në dosje;
Ndihton në punën e zyrave të ndryshme në Gjykatë, duke përfshirë regjistrimin, gjykimet etj.; Kryen edhe punë tjera sipas nevojës:

Kualifikimet:

- Diploma e Fakultetit Juridik programi i studimeve (4) vjeçar apo 240 kredi ECTS ose Master,
- Njohuri të procedurave gjyqësore;
- Aftësi për kryerjen e hulumtimeve gjyqësore (juridike);
- Njohuri të mjaftueshme ligjore;
- Aftësi në përpilimin me shkrim të drafteve juridike, duke përfshirë aftësinë në përpilimin e dokumenteve ligjore, si dhe shkathtësi komunikimi në të folur.

VEREJTJE:

- Procedura e konkursit është e hapur për kandidatët të jashtëm dhe nëpunësit civil ekzistues.
- Procedura e rekrutimit zhvillohet sipas procedurave të parapara me Rregulloren, Nr.08/2017, për Praktikantë Vullnetar.

- **Konkursi është publikuar më dt. 04.03.2024 dhe mbyllet me dt.18.03.2024**

Aplikacionet mund t'i merrni dhe t'i dorëzoni në Gjykatën Themelore në Gjakovë, në Rahovec dhe në Malishevë

Dorëzimi i aplikacioneve mund te bëhet edhe përmes postës.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni në tel: 0390/324130, prej orës 08:00 - 16:00.

Ky konkurs ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale,

Aplikacioni pas skadimit të afatit të konkursit nuk pranohen. Për shkak të numrit të madhe të kërkesave të pranuar vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë banorët e Kosovës prej moshës 18-64 vjeçare. Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe lexueshëm. Në aplikacion duhet të shënohen të gjitha të dhënat e kërkuara. Duhet të përcaktohet saktësisht vendi dhe pozita për të cilën konkurren. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurrim, siç janë: kopja e diplomës për shkollën e kryer, specializimet e ndryshme profesionale, certifikata të tjera, dy rekomandime etj.

Nëse aplikacionit nuk ia bashkëngjitni dokumentet e duhura dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, ju vetë do ta humbni rastin për t'u futur në listën e ngushtë.

Fotokopjet e dokumenteve të bashkëngjitura në aplikacion kandidatët nuk kanë të drejtë ti tërheqin prapa.

[Shkarko Aplikacionin](#)